



KOLEGJI - COLLEGE
BIZNESI
Prishtinë

KOLEGJI "BIZNESI"

Nr. 514-1/24 Data 23.09.2024
PRISHTINË

Mekanizmat e Apelimit për Studentët

Studentët e Kolegjit Biznesi kanë të drejtë të paraqesin **ankesë ose apelim** për çdo çështje që lidhet me:

- procesin mësimor dhe vlerësimin;
- sjelljen etike të stafit ose studentëve të tjerë;
- shërbimet administrative;
- shkeljen e të drejtave të tyre akademike.

Hapat e procedurës së apelimit

Hapi 1 – Paraqitja e ankesës

Studenti e paraqet ankesën me shkrim përmes Administratës së Kolegjit Biznesi.

Hapi 2 – Roli i Administratës

Administrata:

- protokolon ankesën;
- vepron si urë lidhëse institucionale;
- e përcjell ankesën te Këshilli i Programit Studimor (KPS) përkatës ose te organi kompetent, varësisht nga natyra e çështjes.

Hapi 3 – Shqyrtimi nga KPS / organi kompetent

KPS ose organi përkatës:

- shqyrton ankesën;
- merr masa për zgjidhjen e saj brenda kompetencave institucionale.

Hapi 4 – Komisioni i Ankesave

Nëse ankesa nuk zgjidhet në këtë nivel (KPS), çështja i përcillet Komisionit të Ankesave të Kolegjit Biznesi për rishqyrtim.

Hapi 5 – KLMSH (instanca përfundimtare)

Në rast se student nuk është i kaqur me vendimin e Komisionit të Ankesave, ajo shqyrtohet nga Këshilli i Lartë Mësimor Shkencor (KLMSH), si instancë përfundimtare institucionale.

Të gjitha ankesat dhe apelimet trajtohen:

- në mënyrë konfidenciale;
- të paanshme;
- pa asnjë formë hakmarrjeje ndaj studentit.

Kryetari i KLMSH

